



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2022:027495
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05482307

Ac.nr.4640/2023

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Besnik Bislimaj, kryetar i kolegjit, Hidajete Gashi Alaj dhe Nora Bllaca Dula, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit E. B., nga Prizreni, të cilin me autorizim e përfaqëson av. S. M. N., nga Prizreni, rr: "I. L.", nr...., kundër të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Prizren (DKA), të cilën me autorizim e përfaqëson Blerim Mazreku, avokat nga Prizreni, për kompensimin e shujtës ditore, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.509/2022, të datës 14.04.2023, në seancën e kolegjit, të mbajtur me datë 20.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e të paditurës Komuna e Prizrenit, Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.509/2022, të datës 14.04.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e atakuar, C.nr.509/2022, të datës 14.04.2023, ka vendosur si në vijim: I. APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit E. B., nga Prizreni si e bazuar. II. DETYROHET e paditura, Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe Shkencës, në Prizren, që paditësit E. B. nga Prizreni, në emër të shujtave ditore, për 180 ditë pune (nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021), të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, apo shumën e përgjithshme prej treqindegjashtëdhjetë euro (360.00 €), me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 11.02.2022, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. III. DETYROHET e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej njëqindnjëzetekatër euro (124.00 €), në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër këtij aktgjykimi e paditura brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar aktgjykimin e goditur për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë ankesën e të paditurës si të bazuar, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta ndryshojë apo ta prish aktgjykimin e ankimuar, ta hedhë poshtë padinë e paditësit dhe çështjen t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rishqyrtim dhe rivendosje.

Nga shkresat e lëndës nuk mund të gjendet se paditësi të ketë paraqitur përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi E. B. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij, me datë 11.02.2022, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi për kompensimin e shujtës ditore, kundër të paditurës, me pretendimet se i njëjti është i punësuar tek e paditura dhe se në bazë të Kontratës Kolektive të Arsimit të njëjtit i takon kompensimi për ushqim për ditët e pranisë në punë (më detajisht si në petitumin e padisë si në shkresa të lëndës). Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse, si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar (*pa shqyrtim kryesor të çështjes*) C.nr.509/2022, të datës 14.04.2023, me të cilin e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të tij.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë, ka theksuar se “ Gjykata përmes kontratës së punës me numër të protokollit 221/2021, të datës 27.09.2021 dhe vërtetimit të lëshuar nga u.d Drejtori M. F. e Shkollës Fillore “H. T.” në Prizren, vërtetoi faktin se paditësi E. B., është në marrëdhënie pune- mësimdhënës pranë Shkollës Fillore “H. T.” në Prizren dhe gjatë vitit 2021, i njëjti ka punuar gjithsej 180 ditë pune. Pasi vërtetimi dhe kontrata janë lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e si të tilla janë të pranueshme edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit të Shkollës Fillore “H. T.” në Prizren dhe kontratës së punës, gjykata i’ua fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës për paditësin E. B. nga Prizreni, përkatësisht paditësi gjatë vitit 2021 ka punuar gjithsej 180 ditë pune.

Më tutje ka theksuar se gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditëses E. B. nga Prizreni, t’ia paguaj kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, konform detyrimeve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, me nr. Nr. 01B/2056 e datës 18.04.2017, dhe Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, e në kuptim të Nenit 55 par.1 dhe 2 të Ligjit të Punës.

Rrjedhimisht, paditësit E. B., për 180 ditë pune, t'ia paguaj shumën e përgjithshme prej treqindëgjatëdhjetë euro (360.00 €).”

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë i është referuar nenit 35 paragraf 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Lidhur me kamatën ka vendosur konform nenit 382, par.1 dhe 2 të LMD-së derisa për shpenzimet e procedurës i është referuar dispozitave ligjore nga neni 449 dhe 452 të LPK-së. Po ashtu lidhur me vendosjen jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në nenin 152 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika o) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë ka gjykuar brenda kufijve të kërkesëpadisë së paditëses dhe nuk ka bërë tejkallim të kërkesëpadisë.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt e ka vërtetuar gjendjen faktike, nuk është kontestues fakti se paditësi për periudhën kohore të specifikuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar ka qenë në vendin e punës. Po ashtu nuk janë kontestuese ditët e pranisë së paditësit në punë për të cilën periudhë kohore kërkon kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, shujtës ngase paditësi E. B. është në marrëdhënie pune me të paditurën, përkatësisht është i punësuar në SH.F.M.U “H. T.” në Prizren, si mësimdhënës dhe për periudhën kohore prej datës 01.01.2021 e deri më datë 31.12.2021, ka punuar gjithsej 180 ditë pune, gjë që vërtetohet përmes Vërtetimit me nr.44/2022, të datës 01.01.2022, lëshuar nga e paditura- SHFMU “H. T.” në Prizren.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsye se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve”. Me paragrafin 2 të këtij neni, përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: a) nivel të vendit, b)*

nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes“. Me paragrafin 3 të këtij neni, përcaktohet se: “Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së Kosovës”. Me paragrafin 5 përcaktohet se: “*Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive...*”. Me nenin 35 paragrafi 7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 22.01.2021 përcaktohet se: “*Të punësuarve, (anëtarë të SBASHK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditë e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune, është 2 (dy €) Euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensim për ushqim*”. Me nenin 45 paragraf 1 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, përcaktohet se: “MASH, SBASHK dhe Ministria e Financave, angazhohen bashkërisht për t’i informuar dhe ndihmuar komunat, këshillat drejtuese të universiteteve dhe drejtoritë e shtëpive të studentëve që të bëjnë planifikimin me kohë të buxhetit dhe koston financiare për zbatimin e dispozitave të nenit 35. paragrafët 5, 7 dhe 11 kur të krijohen mundësitë financiare në buxhetin e Republikës së Kosovës, por jo më vonë se viti 2023“.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar se në këtë rast ekziston detyrimi juridik - civil, ndaj paditësit në emër të pagesës për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të pranisë në punë, për arsye se me nenin 245 paragraf 1 të LMD-së, përcaktohet se: “*Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbush atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij*”.

Gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditësit, duke e detyruar të paditurën që paditësit t’i paguaj në emër të ushqimit për ditët e kaluara në punë, me të drejtë është bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2017, të lidhur dhe nënshkruar nga Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Kosovës (SBASHK-ut) dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës (MASHT), e cila kontratë ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021 dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës.

Gjykata e Apelit vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar dispozitën e nenit 152 të LPK-së i cili shprehimisht përcakton “*Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij*”. Nga interpretimi i kësaj dispozite ligjore, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka vepruar kur ka gjykuar këtë çështje kontestimore pa shqyrtim kryesor të çështjes pasi janë plotësuar kushtet ligjore në rastin konkret.

Vendimi mbi kamatën e përcaktuar është në përputhje me dispozitën e nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi mbi shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitën nga neni 452 të LPK-së, ndërsa veprimet e ndërmarra në këtë çështje juridike kontestuese janë arsyetuar drejtë, në përputhje me tarifën për përcaktimin e lartësisë së shpenzimeve dhe në pajtim me dispozitat e LPK-së.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragraf 1, pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4640/2023 datë 20.03.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Besnik Bislimaj